



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Rasti i përfuturit të kontrollit të shoqërive First Data Slovakia S.R.O dhe First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A. nga shoqëria SIA S.p.A.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë SIA S.p.A. ka informuar Autoritetin e Konkurrencës me shkresën Nr. 426 Prot., prot i AK, datë 12.07. 2018 “Konfirmimi i depozitimit të Dokumenteve” lidhur me blerjen nga ana e SIA S.p.A. të 100% të kuotave të shoqërive First Data Slovakia S.R.O dhe First Data Hellas Processing Services and Holdings S.A.

Palët në transaksion janë:

Blerësi: SIA S.p.A., një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Italisë me objekt te veprimtarisë së saj studim, projektim, realizim dhe menaxhim te infrastrukturës telematike, sistemeve te informacionit, sistemet e te dhënave bankare të dhënies së kredive dhe financimeve etj.

Shitësi 1: FIRST DATA HOLDING I (NETHERLANDS) BV, shoqëri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të shtetit të Holandës,

Shitësi 2: FIRST DATA OPERATION (AUSTRI), shoqëri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të shtetit të Austrisë.

Shoqëria target 1: FIRST DATA SLOVAKIA s.r.o. (FD Slovakia), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të shtetit të Sllovakisë. Referuar ekstraktit te shoqërisë, FIRST DATA HOLDING I (HOLANDË) është zotëruese e 100% e kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria target 2: FIRST DATA HELLAS S.A. (FD Greqi), shoqëri anonime, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Greqisë e cila zotërohet nga FIRST DATA OPERATION (AUSTRI).

Shoqëritë target ofrojnë shërbimet e out-puting, siç janë përgatitja e POS (point of sale) dhe shërbimet mbështetëse për POS-et dhe ATM.

Sipas të dhënave të deklaruara nga palët, FD Greqi dhe FD Sllovaki realizon të ardhura në Shqipëri.

Në datë 24 maj 2018 është lidhur Marrëveshja për shitjen dhe blerjen e të gjitha interesave të pjesëmarrjes së FD Sllovakia dhe të gjithë kapitalit aksionar të emetuar nga FD Greqi nga shoqëria SIA S.p.A .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.